



DATË:	31.01.2024
REFERENCË:	NJMBNJ
PËR:	zt. Bashkim RAMOSAJ -Kryetar i komunës
CC:	Ministrisë së Punëve të Brendshme-DMZP
NGA:	Ismet KUKLECI -Menaxher i Burimeve Njerëzore
TEMA:	RAPORTI VJETOR PËR VITIN 2023 NGA NJËSIA PËR MENXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE-NJMBNJ

Në vitin 2023 Komuna e Deçanit, kishte 11 pozita të autorizuara për Shërbyesit Civil. Në këtë numër përfshihen nëpunësit e Shërbimit Civil.

Plani i Personelit për vitin 2023, ka planifikuar 11 pozita të lira për pranim, avancim dhe lëvizje brenda kategorisë nga të gjitha kategoritë e Shërbimit Civil.

Realizimi i Planit të Personelit për vitin 2023, është përbushur përmes 13 konkurseve publike, lëvizje brenda kategorisë në shërbimin civil 1, konkurse për ngritje (avancim) në detyrë në shërbimin civil 2, konkurse për pranim në shërbimin civil 10, ndërsa konkurse për pranim në nivelin teknik dhe mbështetës 0.

➤ Lëvizjet brenda kategorisë në Shërbimin Civil

Nr.	Pozita	Njësia	Konkursi	Numri i kandidatëve të suksesshëm
1.	Zyrtar i Pasurisë	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	RN00010983	1

➤ Ngritje në detyrë në Shërbimin Civil

Nr.	Pozita	Njësia	Konkursi	Numri i kandidatëve të suksesshëm
1.	Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	RN00012227	1
2.	Udhëheqës i Sektorit për Shërbime me Qytetar	Drejtoria për Administratë	RN00011394	1

➤ Pranim në Shërbimin Civil

Nr.	Pozita	Njësia	Konkursi	Numri i kandidatëve të suksesshëm
1.	Zyrtar i Gjendjes Civile	Drejtoria për Administratë	RN00010613	2
2.	Arkëtar	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	RN00010614	1
3.	Zyrtar për Shërbim me Qytetar	Drejtoria për Administratë	RN00009824	1
4.	Zyrtar i të Hyrave Financiare	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	RN00011468	1
5.	Zyrtar për Mbledhje të Detyrueshme	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	RN00011469	0
6.	Zyrtar për Tatimin në Pronë	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	RN00011470	0
7.	Arkëtar	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	RN0001228	0
8.	Zyrtar Ligjor 2	Drejtoria për Arsim	RN00012232	0
9.	Zyrtar për Shërbim me Qytetar	Drejtoria për Administratë	RN00012234	0
10.	Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi 4	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	RN00012230	0

Gjatë vitit 2023 i është kushtuar vëmendje edhe nevojave për trajnimin e nëpunësve civil ekzistues dhe nëpunësve të rinj, në bashkëpunim me IKAP, ku janë mundësuar trajnime për profilet përkatëse tek nëpunësit ekzistues mirëpo nuk ka qenë i mundur trajnimi hyrës për nëpunësit e rinj si pasojë e mungesës së organizimit nga IKAP.

Dosjet individuale elektronike për nëpunësit e shërbimit Civil janë përpunuar edhe gjatë vitit 2023, duke u ngarkuar dokumentet (e munguara). Ndërsa dosjet individuale elektronike për shërbimin civil janë përpunuar dhe plotësuar gjatë viteve paraprake.

Ligji me Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ka filluar të zbatohet nga fillimi i muajit shkurt 2023. Si pasojë e implementimit të tij, pagat e muajit shkurt 2023, sipas propozimeve nga institucioni dhe aprovimi nga komisioni i DMZP-së, kishin ndodhur disa gabime në koeficient, mirëpo Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka përcjell/ofruar në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-DMZP propozimet dhe dokumentet e secilit nëpunës me qëllim të korigjimeve në gabimet që kishin ndodhur në koeficientet/vlerën e pagave të ekzekutuara, si rezultat i kësaj, viti 2023 është përmbyllur me të gjitha gabimet e korigjuara nga DMZP/MPB dhe të ekzekutuara në listën e pagave përmes MFPT-Divizioni i liste pagave.

Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ka filluar të zbatohet nga fundi i shtatorit 2023. Komuna e Deçanit, ka filluar zbatimin e dispozitave të këtij ligji në procedurat e pranimi/rekrutimit për

nëpunësit e shërbimit publik dhe nëpunësit teknik/mbështetës. Ndërsa procedurat e pranimit/rekrutimit për nëpunësit e shërbimit civil sipas dispozitave të këtij ligji do të procedohen në pjesën e parë të vitit 2024, kur sistemi informativ për menaxhimin e burimeve njerëzore të jetë kompletuar dhe përshtatur me procedurat e reja ligjore.

Komisioni i Ankesave për Nëpunësit Civil në Komunën e Deçanit, gjatë vitit 2023 ka pranuar gjithsej 6 (gjashtë) ankesa prej të cilave 6 (gjashtë) i ka refuzuar.

Komisioni Disiplinor për Nëpunësit Civil në Komunën e Deçanit, gjatë vitit 2023, nuk ka zhvilluar asnjë procedura disiplinore.

Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit e shërbimit civil është realizuar në formatin elektronik përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore-SIMBNJ.

Komuna e Deçanit, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ka përpiluar Planin e Personelit për vitin 2024, me Nr. PP00001709 përmes SIMBNJ dhe i njëjti pas aprovimit nga Kryetari i Komunës është publikuar në ueb faqen e Komunës së Deçanit.

Ky raport është punuar në përputhje me nenin 16 par. 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i njëjti do të publikohet në ueb faqen e Komunës së Deçanit, ndërsa deri me 15 shkurt 2024, një kopje e këtij raporti do të dorëzohet në Ministrinë e Punëve të Brendshme-(Departamentit për Menaxhimin e Zytareve Publik)-DMZP-Prishtinë.

Udhëheqësi i Njësise për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore/NJMBNJ



Ismet KUKLECI